



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ENGROUP" Sh.P.K. të datës 02.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ENGROUP" Sh.P.K. e datës 02.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "ENGROUP" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "ENGROUP" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

## **Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

**Pretendimi i parë ankimor:** *“Kërkesa e AK për një shkollë me sallë të sportit në vlerë min. 2.5 mil. e paraqitur është në kundërshtim me LPP nenin 69.6.2. dhe është kriter diskriminues e cila e favorizon një kompani të vetme në kundërshtim me nenin 7... Po ashtu përqindja prej 70% që duhet të plotësohet nga lideri i grupit është në kundërshtim me nenin 26.10 të RRPP”.*

**Pretendimi i dytë ankimor:** *“Inxhinierët të cilët janë kërkuar të jenë të certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa EN 16247 si kërkesë bie ndesh me parimet themelore të nenit 7 të LPP”.*

**Pretendimi i tretë ankimor:** *“Duke u nisur prej menaxherit të kontratës që është inxhinieri kryesor i kësaj kontrate, nuk është kërkuar të ketë udhëhequr kontrata të ngjashme kurse për stafin tjetër është kërkuar të kenë udhëhequr kontrata të natyrës së ngjashme”.*

**Pretendimi i katërt ankimor:** *“Për testimin e gypave mundet me qenë i certifikuar edhe një punëtor sipas EN 805/W400. Nuk ka nevojë që inxhinieri i hidroteknikës të jetë i certifikuar për menaxhimin e vendpunishtës”.*

**Pretendimi i pestë ankimor:** *“Kërkesa e ISO 39001 – Menaxhimi i trafikut rrugor është i panevojshëm sepse nuk kemi të bëjmë me menaxhimin e trafikut”.*

**Pretendimi i gjashtë ankimor:** *“Përdorimi i kriterit të kualifikimit për planin dinamik edhe si kriter i vlerësimit është në kundërshtim me RRPP”.*

**Pretendimi i shtatë ankimor:** *“Po ashtu edhe pikën 4 Aneksi 8 – Lista e pajisjeve janë të tepërta dhe nuk përkojnë me projektin në fjalë”.*

**Sa i përket pretendimit të parë ankimor,** argumenti i parashtruesit se nuk mund të kufizohet kërkesa vetëm në projektet për ndërtimin e shkollës është pretendim i bazuar. Prandaj në kuptim të nenit 7 të LPP kjo kërkesë mund të riformulohet ku në vend të kërkesës për të dëshmuar përfundimin e projektit “shkollë me sallë të sportit” mjafton të thuhet përfundimin e projekteve “të ngjashme”. Sa i përket vlerës 2.5 mil dhe peshën bartëse të liderit të grupit te grupet e operatorëve ekonomik, parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë argument të qëndrueshëm për të mbështetur pretendimin ankimor. Prandaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

**Sa i përket pretendimit të dytë ankimor,** parashtruesi nuk ofron asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij ankimor. Në anën tjetër dëshmia e kërkuar dokumentare është e domodoshme për të dëshmuar kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për realizimin me sukses të kontratës. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

**Sa i përket pretendimit të tretë ankimor,** vlen të theksohet që kërkesa e vendosur sipas të cilës inxhinierët duhet të dëshmojnë se kanë udhëhequr projekte të ngjashme duhet të riformulohet pasi që mjafton që inxhinierët të dëshmojnë se kanë marrë pjesë në realizimin e projekteve të ngjashme por jo edhe të kenë udhëhequr ato. Kërkesa për udhëheqje të projekteve mund të kërkohet për udhëheqësin e vendpunishtes nëse kjo konsiderohet si e nevojshme. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

**Sa i përket pretendimit të katërt, të pestë dhe të shtatë ankimor,** parashtruesi vetëm pretendon se këto kërkesa nuk janë të nevojshme mirëpo nuk prezanton asnjë argument për të mbështetur pretendimet e tij. Duhet cekur se këto dëshmi dokumentare janë të

domodoshme për të dëshmuar kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për realizimin me sukses të kontratës. Pretendimet ankimore janë të pabazuara.

**Sa i përket pretendimit të gjashtë ankimor,** duhet cekur se parashtruesi e elaboron këtë pretendim ankimor duke u bazuar te kërkesa për të plotësuar me rregull Planin Dinamik ndërsa pretendimin si të tillë e formulon duke kundërshtuar kriteret e vlerësimit mirëpo në fund nuk parashtron asnjë propozim se si duhet të riformulohet kjo kërkesë sipas këndvështrimit të parashtruesit. Me këtë rast duhet cekur se Plani Dinamik është i domosdoshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk është as ligjore por as logjike që të ndryshohet kjo kërkesë e dosjes së tenderit. Ndërsa kriteret e vlerësimit janë përcaktuar me njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit. Pra pretendimi ankimor është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar vetëm si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 09.02.2024**



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.